



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 21 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.10/03, prill 2019), nenit 26 paragrafët 1 dhe 2 nën paragrafi 1.2 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 14 paragrafi 2.4 dhe nenit 17 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 nëntor 2024, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. NË PODUJEVË

Neni 1

Miratohet propozimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Ndërmarrjes Publike Lokale NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, në Podujevë, pa procedurë të rregullt konkurrimi.

Neni 2

Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është:

1. Pronat të cilat shtrihen në parcelat kadastrale nr.**P-71712062-1541-2** gjegjësisht **9123,99 m²** nga kjo Njësi kadastrale e cila gjendet në Zonën Kadastrale Podujevë.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Podujevës, të cekur në nenin 2 të këtij vendimi, është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale e cila është kërkuar nga NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, në Podujevë.

Neni 4

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës e cila shtrihet në njësinë në pronën e paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 2 të këtij vendimi është (30) tridhjetë vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

Neni 5

Prona e paluajtshme e cekur në nenin 2 të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.

Neni 6

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

Neni 7

Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në nenin 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.

Neni 8

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë kompetente të Komunës së Podujevës.

Neni 9

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- Skica Grafike;
- Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronës;

Neni 10

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-463/06-0072298/24
Podujevë, datë: 04 nëntor 2024





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712062-01541-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/06-0029098/24

Data dhe koha e tëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

29.10.2024 - 09:04

Komuna / Opština / Municipality:

PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Podujevë / Podujevo / Podjevë

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71712062-01541-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shogërore / Drushhevna Imovina / Socially owned Land	Urban	20000	RDP-2005	20.04.2016	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
HAVOLLET-FIDANISHTIA E POSHTME			20.04.2016	



A2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broji Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutino koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/Pojlopjritvredho/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klase/2nd Class Arable Land	20000

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broji ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEJVE / PODUEJVO / PODJEVÉ /		NUHI GASHI	1/1	RDPP-2005	20.04.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Podujevë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71712062-01541-2	Parcelë / Parcela / Parcel	20000



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1280

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica
Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 29.10.2024
Koha/ Vreme/ Time: 09:18:25